

Komandant Hoxha për paramilitarët e Gruevskit: Paramilitarët e pampersave Maqedonia

Postuar nga: redaksia

Postuar në: 2017/3/13 6:24:58



Xhezair Shaqiri ose ish Komandant Hoxha është tallur me paralajmërimin për paramilitarët e Nikolla Gruevskit që janë gati ta mbrojnë Republikën e Maqedonisë.

“Nëse dalin në aksion këto paramilitar të Nikolla Gruevskit paska me u bo nami në Maqedoni:

Nëpër shitore paska me u ndje dukshëm mungesa e pampersave dhe ata qytetar që kanë nëpër shtëpitë e tyre fëmijë foshnje duhet që të nguten të sigurojnë pampersat si dhe biznesi me pampersa do të jetë në rritje;

Higjiena komunale paska nevojë për kontiner të rinj, pasi që pampersat janë për një përdorim; Ministria e shëndetësisë në Maqedoni duhet që të angazhon më shumë psikiatra dhe të ndërton spitale psikiatrike ;

Në vitin 2001 po këta paramilitar posedonin armatim të rëndë dhe përkrahjen e ushtrisë së ARM-së dhe Policisë dhe para secilës ofenzivë më së paku dy javë grasatonin prej së largu pozicionet e UCK-së dhe kur realizonin sulmin ishin të strehuar nëpër blinda.

Në kundërsulmet e para të UCK-së këta edhe pse ishin të strehuar nëpër blinda zbrapseshin menjëherë.

Paramendoni tani pa ndihmën e policisë dhe ushtrisë dhe pa armatim të rëndë, vetëm me armatim të lehtë se çfarë sulmesh mund të bëjnë.

Taksirat me i lënë fëmijët pa pampersa.”, shkroi Xhezair Shaqiri në llogarinë e tij në Facebook.

/lajmpress